

1. A keni kryer analiza për praninë e aflatoksinave dhe OTA në drithërat e importuara dhe të eksportuara përgjatë periudhës kohore 2014-2025? Nëse po, kërkojmë një kopje të këtij raporti.

2. Kërkojmë një kopje të raportit në lidhje me numrin e rasteve të refuzimit ose të bllokimit të ngarkesave për shkak të tejkalimit të niveleve maksimale të lejuara përgjatë periudhës kohore 2014-2025.

3. A keni patur njoftime në sistemin RASFF që lidhen me produkte shqiptare të kontaminuara me aflatoksina, përgjatë periudhës kohore 2014-2025? Nëse po, kërkojmë një kopje të këtij raporti.

Ju bëjmë me dije se pranë pikave kufitare/doganore të RSH, përvec autoritetit doganor në lidhje me kontrollin/llet mbi eksportin dhe importin e mallrave, operojnë edhe autoritete të tjera publike (veterinare, sanitare, fito-sanitare, farmaceutike, etj) sipas fushës së përgjegjesisë që u njeh legjislacioni vendas.

Për sa keni kërkuar, bazuar në nenin 12 të ligjit 119/2014, autoriteti publik, bazuar në kompetencat dhe funksionet administrative të dhëna nga ligji, konstaton se nuk është mbajtës/titullar i informacionit të kërkuar.

Për kërkesat tuaja ju duhet ti drejtoheni autoriteteve të tjera publike që mbulojnë fushën e kërkuar.